



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME**

---

A-REV.nr. 6/2024

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Ragip Namani, kryetar, Nebojša Borčić dhe Zenel Leku anëtar, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Zanë Buçinca, procesmbajtëse, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit, O.S.,T dhe T.,(KOSTT),SH.A., me seli në P., kundër të paditurës Administrata Tatimore e Kosovës, me seli në P., me bazë juridike, vlerësim tatimor, duke vendosur sipas revizionit të paditësit KOSTT, kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.648/22, të datës 18.05.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë, 25 Prill 2024, merr:

**A K T V E N D I M**

Hedhet i palejuar Revizioni i paditësit, O.S. T., dhe Tregu,(KOSTT), SH.A., i parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.648/22, të datës 18.05.2023.

**A r s y e t i m**

Me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, K.DH.SH.II.nr.648/22, të datës 18.05.2023, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, O.S., T.,dhe T.,(KOSTT),SH.A., me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A nr. 1957/19, i datës 04.11.2021, vërtetohet.

Kundër aktgjykimit të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale, paditësi KOSTT, në Gjykatë Supreme parashtron revizion, me të cilin e konteston ligjshmërinë e të njëjtit për shkak të: shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe aplikimit të gabuar të dispozitave materiale, me propozim, Gjykata Supreme të nxjerrë aktvendim ashtu që ta ndryshojë aktgjykimin e Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, në Prishtinë, K.DH.SH.II.nr.648/22, të datës 18.05.2023, dhe të Anulohet pjesërisht vendimi i ATK, respektivisht pika I e vendimit me nr. 181/2019, i datës 17.07.2019, përkatësisht ANULOHEM pika I., e Raportit të Kontrollit të datës 29.03.2019, lidhur me çështjen e tejkalimit të humbjeve të Energjisë Elektrike, si i pa bazuar dhe detyrohet ATK të bëjë korrigjimet e nevojshme sipas këtij aktgjykimi.

Gjykata Supreme shqyrtoi revizionin e ushtruar në pajtim me nenin 52.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), dhe gjen se;

Revizioni i paraqitur është i palejuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktgjykimin e kontestuar të Gjykatës Komerciale-Dhoma e shkallës së dytë, K.DH.SH.II.nr.648/22, të datës 18.05.2023, refuzohet si e pa bazuar ankesa e paditësit, Operator S., T., dhe T.,(KOSTT),SH.A., me seli në P., ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A nr. 1957/19, i datës 04.11.2021, vërtetohet, me të cilin refuzohet kërkesëpadia e paditësit O.S., T., dhe Tregu,(KOSTT),SH.A., me seli në P., si e pa bazuar, ndërsa mbetet në fuqi Vendimi nr.181/2019, i datës 17.07.2019 i Divizionit të Ankesave të Administratës Tatimore të Kosovës.

Neni 24 të Ligjit për konfliktet administrative (LKA) përcakton se, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtojë në Gjykatë Supreme të Kosovës, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor. Kërkesa mund të parashtrohet vetëm për shkak të shkeljes të drejtës materiale, ose të shkeljeve të dispozitave të procedurës, që do të mund të kishte ndikim në zgjidhjen e çështjes.

Neni 25 (LKA) përcakton se, kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës, prokurori publik mund t'i parashtojë Gjykatës Supreme të Kosovës kërkesën për mbrojtjen e ligjshmërisë, nëse me vendim të tillë është shkelur ligji, dispozitat e tjera ose akti i përgjithshëm.

Sipas nenit 50 (LKA) kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimin të vendimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën. Ndërsa kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë paraqitet brenda nëntëdhjetë (90), ditëve nga dita kur u është dërguar palëve vendimi, kundër të cilit paraqitet kërkesa.

Sipas nenit 13, parag.1., të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet kompetenca e Gjykatës Komerciale, për të gjykuar në shkallën e parë dhe të dytë, ndërsa sipas pikës 1.11, të këtij neni, përcaktohet (kompetenca ekskluzive e kësaj gjykate për të gjykuar), citim, *“kontestet administrative, të iniciuara nga Shoqëritë Tregtare kundër vendimeve përfundimtare të ATK të Autoriteteve Doganore, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik përgjegjës për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve të tjera shtetërore”*. Dhe sipas pikës 1.12, *“kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative”*.

Sipas nenit 14 të parag.1., të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet, *“lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike, kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale të Republikës së Kosovës, zbatohen ligjet procedurale në fuqi”*.

Duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes dhe dispozitave të cituara si më lartë të Ligjit për Konflike Administrative dhe nenit 14 par.1, të Ligjit për Gjykatën Komerciale, kjo gjykatë gjen se, kundër vendimeve të formës së prerë për konteste administrative të gjykatës së shkallës së dytë, pra edhe të Gjykatës Komerciale në kontestet administrative nga neni 13, pika 1.11, dhe 1.12, pala mund të parashtrijë në Gjykatë Supreme mjet juridik të jashtëzakonshëm, kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, ndërsa prokurori publik kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë. Nga theksimet si më lartë rezulton se, me revizion nuk mund të kontestohen vendimet e formës së prerë për konteste administrative të gjykatës së shkallës së dytë , prandaj kjo gjykatë e hedhë poshtë revizionin e parashtruar nga paditësi si të palejuar.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 52.1, lidhur me nenin 24 dhe 25, të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME – PRISHTINË

A.REV. nr. 6/2024, datë 25 Prill 2024

B. Profesionale,  
Zanë Buçinca

Kryetari i Kolegjit,  
Ragip Namani